



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-17089 /25

Klinë, dt: 11.06 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 08.05.2025, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti drejtorët, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Informatë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2028 (ref.Drejt.Fin.);
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt prill-maj 2025;
5. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Mirë se keni ardhur në takimin e rregullt të KPF-së. Jemi prezent 6 nga 7 anëtarët. Asdreni ka konfirmuar se s'mund të marrë pjesë. Besoj që ftesën me material e keni marr. A ka dikush për rend të ditës?

Me 6 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Mungon Asdren Ramadani, me arsye.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: Kush është për miratim të këtij procesi?

Me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Informatë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2028 (ref.Drejt.Fin.).

Fadil Gashi, kryesues: Ndoshta drejtori i Financave, z. Enver Berisha na informon më shumë. Po, urdhëro drejtor!

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për anëtarët e KPF-së. Realisht, kemi pritur që këto ditë niveli ministror të na dërgojë Kornizën Afatmesme Buxhetore. Praktikisht, drafti i buxhetit për vitin 2026 ende nuk është dorëzuar. Kjo për shkak të situatës së krijuar në nivel nacional, në Kuvendin e Kosovës dhe në procesin zgjedhor. Megjithatë, ne kemi qenë të obliguar që ta vendosim këtë pikë në rend dite, pasi afatet janë të përcaktuara. Deri më 15 të këtij muaji duhet të kemi pranuar Kornizën, sepse kemi ndërmarrë të gjitha hapat për përgatitjen e KAB-it. Është formuar komisioni përgjegjës dhe kemi përgatitur edhe agjendën gjatë këtij muaji, në mënyrë që në qershor të vazhdojmë me takimet në terren. Kemi planifikuar të mbajmë takim me kryetarët e zgjedhur të bashkësive lokale, për t'i informuar për Kornizën Afatmesme Buxhetore. Në këto takime do të ftojmë edhe qytetarët, që të bëhen pjesë e propozimit të projekteve për vitet 2026–2028. Jemi ende në pritje të kufijve buxhetorë. Besoj që deri më 15 maj duhet të na arrijnë, që të jemi të përgatitur për seancë. Diçka më tepër nuk mund të them, për shkak se gjithçka varet nga niveli ministror. Faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor. Me keqardhje, ka shumë pak shpresë që kjo të ndodhë. Nuk ka kush të procedojë; trupat në nivel qendror nuk funksionojnë më. Nuk e di, por afati i fundit është 30 qershori.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Ka një mundësi të vogël, për shkak të një nisme që është marrë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Aty mungon vetëm përfaqësuesi i ministrisë, të tjerët janë. Dua të besoj që deri më 15 maj mund të marrim një përgjigje.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush tjetër që dëshiron të marrë fjalën? Urdhëro, Tunë Deda.

Tunë Deda: Përshëndetje, kryesues, drejtor, dhe gjithë të pranishmit. Unë dua t'ju falënderoj ju drejtor që e keni përfshirë këtë çështje në rend dite, edhe pse materiali nuk ka arritur ende. Por,

fajin nuk e keni ju, ai është në nivelin e ministrisë, ose më saktë në nivelin e Qeverisë. Shpresojmë që të gjejmë një zgjidhje me kohë, pasi kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe ky dokument duhet të jetë i pranishëm. Si Kuvend dhe si komunë e Klinës, ne jemi të varur nga buxheti për vitin që vjen. Faleminderit shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër?

Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt prill-maj 2025.

Kërkesa 1

Kërkesë e parashtruar nga Famullia “Zoja e Këshillit të Mirë” në Klinë, me anë të së cilës kërkojnë që të ndahet një shumë prej 15,000.00 euro nga buxheti i Komunës së Klinës për realizimin e projektit asfaltimin e oborrit të Kishës “Zoja e Këshillit të Mirë” në Klinë.

Tunë Deda: Faleminderit shumë, kryesues. Edhe pse kërkesa është në vlerë prej 22,000 eurosh, unë propozoj dhe pajtohem që të procedohet njëjtë si në rastin e Bashkësisë Islame - me 15,000 euro. Duke marrë parasysh se kërkesa është e arsyeshme, por fushat buxhetore nuk lejojnë më shumë, atëherë le të procedojmë me këtë shumë. Bashkësia Katolike le të vazhdojë me pjesën tjetër të projektit. Faleminderit shumë.

Fadil Gashi, kryesues: Realisht, edhe ata kanë kërkuar 15,000 euro. Këta e kanë potencuar lejen e projektit, andaj kërkojnë nga Kuvendi që të mbështeten të paktën me këtë shumë. A ka dikush tjetër për diskutim?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Famullia “Zoja e Këshillit të Mirë” në Klinë, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kërkesa 2

Kërkesë e parashtruar nga z. Hazir Jakupi nga fshati Caravik i Komunës së Klinës, me anë të së cilës kërkon lejin e ndërtimit të lapidarit për dëshmorin Fitim Jakupi në parcelën 00149-0, pronë shoqërore e Komunës së Klinës. Po ashtu, deklaroi se lapidari do të ndërtohet me mjete vetanake dhe se për ndërtimin e tij ka pëlqimin e banorëve.

Fadil Gashi, kryesues: Kemi rekomanduar këtë çështje në Drejtorinë e Inspektoratit, të cilët kanë dalë në terren dhe kanë përgatitur një raport. Gjendja faktike, siç është konstatuar, është që familjet në fjalë nuk kanë pasur raporte të mira as para dhe as pas luftës. Si komision, konstatojmë se nuk jemi organ kompetent për të lëshuar leje ndërtimi. Ata janë drejtuar në bazë të Rregullores Komunale për Varreza, por kjo kërkesë nuk lidhet me varrezat; është çështje e ndërtimit të një lapidari. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e bën organi kompetent për çështje të shërbimeve komunale, përfshirë edhe inspektoratin sanitar. Situata është e ndërlikuar. Ne nuk mund të marrim vendim në këtë rast, për shkak të konfliktit mes dy familjeve. Ne nuk

jemi organ që ndan drejtësinë, kjo është kompetencë e gjykatave. Nëse marrim një vendim si Kuvend, rrezikojmë të rëndojmë situatën edhe më tej. Më mirë është që palët të ndjekin rrugët ligjore dhe t'i drejtohen gjykatës, e cila mund të marrë një vendim të drejtë.

Tunë Deda: Sipas asaj që pashë, kërkesa është për ngritjen e një lapidari aty ku është varrosur personi. Nëse varri ndodhet aty, atëherë të mos lejohet ndërtimi i lapidarit më duket e padrejtë. Do t'i bëja thirrje kësaj familjeje që të ulen dhe të merren vesh, ose të zhvendosin lapidarin në një vend tjetër, me ndihmën e komunës. Komuna mund të marrë përsipër ngritjen e lapidarit në një lokacion tjetër, duke negociuar me familjen. Përndryshe, kjo është një situatë shumë e ndërlikuar dhe e rëndë. E kuptoj që ky nuk është kompetencë e Kuvendit dhe as nuk duhet të ndërhyjmë në konflikte familjare. Nuk është që po themi se kërkesa duhet të refuzohet apo pranohet, po themi që nuk është kompetencë e jona. Dhe kjo është më e ndershme sesa të marrim një barrë që nuk na takon, ligjërisht as moralisht. Ne nuk kemi ndonjë rast të ngjashëm që Kuvendi ka lëshuar leje për ngritjen e lapidarit. Edhe në rastin e mëparshëm kemi marrë përgjigje negative. Prandaj, më mirë është të tërhiqemi nga një vendim që nuk e kemi si përgjegjësi.

Gjykata është institucioni më i përshtatshëm për të vlerësuar drejtësinë në këtë rast. Ne duhet të ruajmë neutralitetin dhe të mos përfshihemi në këtë konflikt familjar.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Hazir Jakupi nga fshati Caravik, duke u bazuar në Rregulloren për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, konstaton se Kuvendi i Komunës nuk është organ që jep leje për ndërtimin e lapidarëve. Me 6 vota PËR, rekomandon që pala të drejtohet tek organet përkatëse për pajisje me leje.

Kërkesa 3

Kërkesë e parashtruar nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, dega në Klinë, me anë të së cilës kërkojnë mirëmbajtjen e monumenteve të dëshmorëve, komplekseve memoriale dhe sheshet e dëshmorëve, si ndërrimin e flamujve, rregullimin e ndriçimit dhe pastrimin e tyre.

Fadil Gashi, kryesues: Besoj që do të ishte mirë që të paktën dy herë në vit, ose së paku gjatë përvjetorëve, të ndërmerren masa për mirëmbajtjen e varrezave, por gjithsesi duhet kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të marrë masa konkrete për mirëmbajtjen dhe pastrimin e këtij lokaliteti. Urdhëro, Tunë.

Tunë Deda: Po, kryesues. Kërkesa e tyre është shumë me vend dhe edhe propozimi yt që kjo t'i adresohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike është i qëlluar. Është e nevojshme që këto hapësira të mirëmbahen rregullisht, jo vetëm një herë në vit, por ndoshta edhe një herë në muaj të kryhet pastrimi i lapidarit. Ata kanë dhënë jetën për këtë vend, dhe ne e kemi për obligim që të kujdesemi dhe të mbajmë të pastra vendet ku janë të ndërtuara këto monumente.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, dega në Klinë, me 6 vota PËR, rekomandoi që kjo kërkesë të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, e cila është përgjegjëse për mirëmbajtjen e tyre.

Kërkesa 4

Kërkesë e parashtruar nga z. Atdhe Tigani, për rrimërimin e rrugës dytësore, e cila aktualisht mban emrin e dëshmorit "Bekim Berisha Abeja", që të ndryshohet dhe të emërohet me emrin e ish - policit, Deli Tigani, i cili tashmë nuk është në jetë.

Fadil Gashi, kryesues: Ne mund të pajtohemi si Komitet dhe ta dërgojmë këtë çështje në Komision. Nëse ata na dorëzojnë raportin gjatë javës së ardhshme, atëherë mund të bëhet pjesë e këtij raporti dhe Komisionit. A ka dikush tjetër? Tunë, urdhëro!

Tunë Deda: Po, unë e kam parë këtë çështje, e kam edhe fqinj, se është nga Zajmi. E meriton të ju ngjitet emri në atë rrugë, vetëm duhet shikuar edhe anën ligjore. Do të ishte problematik nëse duhej të hiqnim emrin ekzistues, por nëse bëhet fjalë për një rrugë të re, atëherë nuk ka asnjë pengesë dhe është e mundur. Në rast se nuk ka mundësi për rrimërim të rrugës ekzistuese, unë propozoj që rrugëve të reja t'u ngjitet emri i tij.

Pika 5. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush në të ndryshme? Atëherë, faleminderit shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim, shihemi në takimin e radhës!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**



**KRYESUESI,
Fadil Gashi**

